



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 28 korrik 2021

**Gjuha në origjinal:** Anglishte

**Klasifikimi:** **Publik**

---

**Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve**

---

**Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Viktimave:**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit:**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Kadri Veselit:**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit:**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:**  
Venkatesvari Alagenda

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli”, dhe “Dhomat e Specializuara”),<sup>1</sup> duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim: (i) kërkesën e përbashkët të parashtruar më 23 korrik 2021 nga Selimi, Krasniqi dhe Thaçi;<sup>2</sup> (ii) kërkesën e parashtruar më 26 korrik 2021 nga Veseli<sup>3</sup> (bashkërisht, “Mbrojtja”); dhe (iii) kërkesën e parashtruar më 26 korrik 2021 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),<sup>4</sup> me anë të së cilave kërkohet ndryshim i afatit për parashtrimin e apeleve kundër “Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara” (“Vendimi i Kundërshtuar”)<sup>5</sup> (bashkërisht, “Kërkesat”). ZPS-ja kërkon gjithashtu ndryshimin e afatit për t’iu përgjigjur apeleve të Mbrojtjes, nëse është e nevojshme.<sup>6</sup>

1. Selimi, Krasniqi dhe Thaçi kërkojnë zgjatjen e afatit për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar deri më 27 gusht 2021.<sup>7</sup> Ata parashtrojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e zgjatjes së kërkuar të afatit për shkak të rëndësisë, kompleksitetit dhe risisë së aspekteve të trajtuara në Vendimin e Kundërshtuar, të cilat nuk janë trajtuar më parë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>8</sup> Selimi, Krasniqi dhe Thaçi cekin më tej

---

<sup>1</sup> F00004, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave lidhur me Afatet, 27 korrik 2021.

<sup>2</sup> F00001, Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit, Krasniqit dhe Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Apeleve kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Mocionet Paraprake, 23 korrik 2021 (“Kërkesa e Përbashkët”).

<sup>3</sup> F00002, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Zgjatjen e Afatit për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-06/F00412 (“Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”), 26 korrik 2021 (“Kërkesa e Veselit”).

<sup>4</sup> F00003, Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatjen e Afateve, 26 korrik 2021 (“Kërkesa e ZPS-së”).

<sup>5</sup> F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

<sup>6</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 1.

<sup>7</sup> Kërkesa e Përbashkët, para. 5, 8.

<sup>8</sup> Kërkesa e Përbashkët, para. 6.

pushimin veror të gjykatës dhe rrethanat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia e KOVID-19.<sup>9</sup>

2. Veseli kërkon ndryshim të afatit, në mënyrë që të mund të dorëzojë apelin e tij ndaj Vendimit të Kundërshtuar brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për vendimin e pritshëm të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kundërshtimet kushtetuese, dhe sido që të jetë, jo më herët se 27 gushti 2021.<sup>10</sup> Veseli parashtron se, për shkak se pikat që ai ngre në mocionet e ndryshme paraprake janë të ndërlidhura dhe/ose të natyrës kushtetuese, vendimi i pritshëm i Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kundërshtimet kushtetuese do ta ndihmonte atë për të bërë një apel “gjithëpërfshirës dhe të bazuar në informacionin e duhur” ndaj Vendimit të Kundërshtuar.<sup>11</sup>

3. ZPS-ja kërkon zgjatje të afatit për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar deri në dhjetë ditë nga marrja e njoftimit për vendimin mbi kundërshtimet kushtetuese ose deri më 27 gusht 2021, cilado datë që është e mëvonshme.<sup>12</sup> Në rast se miratohen ndryshimet e afateve të kërkuara nga Mbrojtja, ZPS-ja kërkon zgjatje proporcionale të afatit, deri më 30 shtator, për t’iu përgjigjur apeleve.<sup>13</sup> ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjet e kërkuara të afateve, duke theksuar se në Vendimin e Kundërshtuar trajtohen aspekte komplekse dhe të rëndësishme, të cilat nuk janë trajtuar më parë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>14</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se, për shkak se disa kundërshtime kushtetuese janë në shqyrtim e sipër nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, palët duhet të kenë mundësinë të marrin parasysh të gjitha vendimet potencialisht të rëndësishme para se të vendosin nëse dhe si ta bëjnë

---

<sup>9</sup> Kërkesa e Përbashkët, para. 7.

<sup>10</sup> Kërkesa e Veselit, para. 8, [10]. Shih gjithashtu Kërkesa e Veselit, para. 3.

<sup>11</sup> Kërkesa e Veselit, para. 6-7.

<sup>12</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 1.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Kërkesa e ZPS-së, para. 2.

apelin.<sup>15</sup> Së fundi ZPS-ja sjell në vëmendje pushimin veror të gjykatës dhe afatet e tjera gjatë tij.<sup>16</sup>

4. Paneli vëren se në përputhje me rregullat 97(3) dhe 170(2) të Rregullores, normalisht palët duhet të parashtojnë apelet e mundshme të tyre kundër Vendimit të Kundërshtuar brenda 2 gushtit 2021, përgjigjet e tyre, nëse do të ketë, brenda dhjetë ditësh nga apeli, dhe kundërpërgjigjet, nëse do të ketë, brenda pesë ditësh nga përgjigjet. Sidoqoftë, Paneli rikujton se rregulla 9(5)(a) e Rregullores lejon ndryshimin e afateve të përcaktuara në Rregullore nëse tregohen arsye të vlefshme ose *proprio motu*.

5. Paneli pranon rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjeve të ngritura në Vendimin e Kundërshtuar si dhe risinë që ato paraqesin para Panelit të Gjykatës së Apelit. Paneli konstaton se zgjatja e afatit do t'i ndihmonte palët të dorëzojnë parashtrime kuptimplota në apel lidhur me këto çështje. Për rrjedhojë, Paneli është bindur se në rrethanat e çështjes aktuale, ekzistojnë arsye të vlefshme, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, për ndryshimin e afatit për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar dhe zgjatjen e tij deri më 27 gusht 2021, si dhe për ndryshimin e afatit për parashtrimin e përgjigjeve ndaj apeleve dhe zgjatjen e tij deri më 30 shtator 2021.<sup>17</sup> Paneli vlerëson se zgjatjet përkatëse të afateve janë të mjaftueshme dhe konstaton se një zgjatje e mëtejshme e afatit për shkak të shpërndarjes së vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi kundërshtimet kushtetuese, nuk është e përligjur. Duke mbajtur parasysh zgjatjet e miratuara të afateve, Paneli zgjat gjithashtu *proprio motu*

---

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Shih p.sh. ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ruto and Sang*, ICC-01/09-01/11-1346, Decision on the request of the Prosecutor for an extension of the time limit for her consolidated response to the documents in support of the appeals, 5 June 2014, para. 9, and the jurisprudence cited in fns 18-19 thereto; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-3431, Decision on Mr Jean-Pierre Bemba Gombo's request for an extension of time for the filing of his document in support of the appeal, 1 September 2016, paras 11-12, and the jurisprudence cited in fns 15-17 thereto; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ruto and Sang*, ICC-01/09-01/11-1971, Decision on the requests for time and page extension, 18 September 2015, paras 6-7.

afatin për dorëzimin e kundërpërgjigjeve nga palët, nëse do të ketë, deri më 18 tetor 2021.

6. Paneli vlerëson se është në interes të drejtësisë dhe të administrimit efektiv të çështjes gjyqësore që të mbahet një kalendar i bashkërenduar për parashtrimet në apel. Për rrjedhojë, të gjitha zgjatjet e afateve të miratuara në këtë Vendim do të zbatohen për të gjitha palët. Për më tepër, Paneli vlerëson se ndryshimet e kërkuara të afateve nuk do të pengojnë kryerjen e shpejtë të procesit në përgjithësi në çështjen aktuale.<sup>18</sup>

7. Paneli rikujton se në bazë të rregullës 9(6) të Rregullores, mocionet për ndryshimin e afateve mund të miratohen pa u dhënë palëve mundësinë për t'u shprehur. Duke pasur parasysh që palëve nuk do t'u shkaktohet asnjë dëm, Paneli vlerëson se është në interes të drejtësisë që të vendosë menjëherë lidhur me Kërkesat.<sup>19</sup>

8. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**MIRATON** Kërkesën e Përbashkët;

**MIRATON** Kërkesën e Veselit dhe Kërkesën e ZPS-së, pjesërisht;

**NDRYSHON** afatin për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar; dhe  
**URDHËRON** palët të dorëzojnë apelet e tyre përkatëse ndaj Vendimit të Kundërshtuar, nëse do të kenë, brenda datës 27 gusht 2021;

**URDHËRON** palët të dorëzojnë përgjigjet e tyre përkatëse, nëse do të kenë, brenda datës 30 shtator 2021; dhe

---

<sup>18</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka miratuar gjithashtu ndryshimin e afatit për kërkesat për leje për apel ndaj vendimit të tij mbi mocionet paraprake për mangësi në formën e aktakuzës dhe zgjatjen e tij deri më 27 gusht 2021. Shih F00413/RED, Versioni i redaktuar publik i Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 22 korrik 2021, para. 178-179.

<sup>19</sup> Paneli vëren më tej se ZPS-ja nuk kundërshton zgjatjet e afateve të kërkuara nga Mbrojtja dhe se Veseli nuk kundërshton një ndryshim të ngjashëm të afatit të kërkuar nga ZPS-ja. Shih Kërkesa e ZPS-së, para. 1; Kërkesa e Veselit, para. 9.

**URDHËRON** palët të dorëzojnë kundërpërgjigjet e tyre përkatëse, nëse do të kenë, deri më 18 tetor 2021.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar**  
**Kryegjykatëse**

E mërkurë, 28 korrik 2021

Në Hagë, Holandë